



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMINE
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “BUJQËSI”

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional **“Bujqësi”** me strukturë 2+1+1, për provimin e detyruar **“Teori profesionale e integruar”** të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e **“Teorisë profesionale të integruar”** bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional **“Bujqësi”**, Niveli II i KSHK-së (klasa e 10-të dhe 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional **“Bujqësi”**, Niveli IV në KSHK (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 **“Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”**.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja si dhe analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të **“Teorisë profesionale të integruar”**, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për për provimin e detyruar të **“Teorisë profesionale të integruar”** të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve të tij, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional **“Bujqësi”** do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë

hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “**Teori profesionale e integruar**”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “ **Bujqësi**“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Bazat e bujqësisë, kl. 10-të dhe 11-të.
2. Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi, kl. 13-të.
3. Përmirësimi uJOR dhe sistemimi i tokave, kl. 13-të.
4. Bazat e bujqësisë organike, kl. 13-të.

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr.	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e bujqësisë	74	39
2	Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi	46	24
3	Përmirësimi uJOR dhe sistemimi i tokave	24	13
4	Bazat e bujqësisë organike	46	24
	TOTALI	190	100%

Temat sipas lëndëve janë:

1. “**Bazat e bujqësisë**”, kl. 10-të dhe kl. 11-të: **(74 orë)**
 - Kuptimi për ekosistemi. 8 orë

- Bimët dhe mjedisi. 10 orë
- Morfologjia dhe fiziologjia e bimëve. 10 orë
- Rritja dhe zhvillimi i bimëve. 8 orë
- Shumëzimi i bimëve. 10 orë
- Toka bujqësore. Horizonti dhe përbërja e tokës. 6 orë
- Tretësirat tokësore dhe reaksioni i tokës. 6 orë
- Plehërimi i bimëve. 8 orë
- Njohuri të përgjithshme për mbrojtjen e bimëve. 8 orë

2. “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi” kl. 13-të: (46 orë)

- Parimet ekonomike të drejtimit të fermave bujqësore. 3 orë
- Drejtimi i fermës dhe kushtet e rrishtit dhe pasigurisë. 3 orë
- Prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë. 2 orë
- Bashkëpronësia dhe shpronësimi. 3 orë
- Kontratat, veçoritë e kontratave në sektorin bujqësor. 4 orë
- Marketingu bujqësor. 3 orë
- Sigurimi i kapitalit dhe kredisë në bujqësi. 3 orë
- Sigurimi dhe përdorimi i tokës. 4 orë
- Sigurimi dhe drejtimi i krahut të punës. 3 orë
- Sigurimi dhe përdorimi i makinerive bujqësore. 3 orë
- Detyrat e kontabilitetit, inventarizimi dhe bilanci në bujqësi. 4 orë
- Pasqyrimi kronologjik i veprimeve ekonomike bujqësore. 3 orë
- Llogaritë e rezultatit dhe llogaritë e mallrave. 5 orë
- Tatimi mbi vlerën e shtuar. 3 orë

3. Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave, kl.13-të: (24 orë)

Për ujqitjen e tokave bujqësore

- Nevojat e bimës për ujë dhe evapotranspirimi. 2 orë
- Norma agronomike e ujqitjes dhe cilësia e ujqit për ujqitje. 2 orë
- Mënyrat e ujqitjes. 5 orë

Për kullimin e tokave bujqësore

- Rrjetet kulluese dhe drenazhimi. 5 orë

Për sistemimin e tokave bujqësore

- Gërryerja e tokës nga uji dhe era, faktorët ndikues të saj. 2 orë
- Sistemimi sipërfaqësor kurriz dhe rrafsh i tokave bujqësore. 4 orë
- Sistemimi ekstensiv dhe intensiv i tokave të pjerrëta. 4 orë

4. Bazat e bujqësisë organike, kl.13-të: (46 orë)

- Kuptimi, rëndësia dhe përparësitë e bujqësisë organike. 4 orë

- Burimet natyrore dhe administrimi i tyre. 10 orë
- Agroteknologjia e prodhimit organik. 10 orë
- Organizmat e modifikuara gjenetikiisht (*OMGJ*). 2 orë
- Mbarështimi organik i kafshëve. Akuakultura organike. 7 orë
- Kalimi nga bujqësia tradicionale në organike. 6 orë
- Legjislacioni dhe rregullat e certifikimit dhe tregtimit të prodhimeve *BIO*. 4 orë
- Mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri. 3 orë